

AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI I SHOQËRISË  
Mercans Albania SHPK

THEMELIMI

Neni 1  
Ortaku themelues

- 1.1 Shoqëria Mercans Albania SHPK themelohet nga Ortaku i Vetëm Z. Marko Taylor, shtetas estonez, lindur më 25.07.1975 ne Estoni, banues ne Villa 326, Mira 1, Dubai, United Arab emirates, mbajtes i Pasaportes me nr. KE0136089.

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

Neni 2  
Emërtimi

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është Mercans Albania.

Neni 3  
Forma ligjore

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4  
Baza ligjore

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

Neni 5



### Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qëndrën Kombëtare të Biznesit ("QKB").
- 5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është per një afat te papercaktuar.

Neni 6

Selia

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Njesia Bashkiake Nr. 2, Rr. Themistokli Germanji, Pallati Pegaso, Kat 7, Zyra Nr. 30 – Tirane.
- 6.2 Administratori i shoqërise mund të vendosë të hapë degë dhe/ose filiale dhe/ose adresa sekondare dhe/ose zyra përfaqësimi të shoqërisë si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj ose mund të crregjistroje ato ekzistuese sipas ligjeve ne fuqi.
- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen në Shqipëri dhe/ose jashte saj me vendim te Administratorit te shoqërisë.

Neni 7

Emblema. Vula

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemët dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjisacionit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përbajnjë emblemët dhe vulën e saj.

Neni 8

Objekti

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është: Ofrimi i sherbimeve te Menaxhimit te Burimeve Njerezore dhe Liste Pagesave per llogari te paleve te treta (Human Resources and Payroll Outsourcing), Ofrimi i sherbimeve te Rekrutimit dhe Proseseve te tjera lidhur me biznesin per llogari te paleve te treta (Recruitment and Business Process Outsourcing), Shitja e programeve kompjuterike (software).

8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 9**

**Kapitali**

9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 10'000 (dhjetemije) Leke.

9.2 Ortaku i Vetëm zoteron 1 (një) kuote, e cila eshte e barabarte me vleren e kapitalit.

9.3 Kapitali është shlyer tërësisht.

**Neni 10**

**Transferimi i kuotave. Kufizimet.**

10.1 Kuotat mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet perkatese.

10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi kuotat në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Ortakut të Vetëm.

**Neni 11**

**Rritja e kapitalit**

11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetëm.

11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 12**

**Zvogëlimi i kapitalit**

12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.

12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpëra marrjes së vendimit nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë. Eksperti kontabël dhe



administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin ortakut të vetëm reportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.

- 12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Ortakut të vetëm të shoqërisë.

## ORGANET E SHOQËRISË

### Neni 13

#### Vendimet e ortakut të vetëm

- 13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Ortaku i Vetëm i saj.

- 13.2 Vendimet e Ortakut të Vetëm përfshijnë kryesisht:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
- Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë si dhe percaktimin e shpërblimit per ta;
- Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe percaktimin e shpërblimit per ta;
- Miratimin e bilancit të shoqërisë e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Transformimin e shoqërisë në formë të tjera.

### Neni 14

#### Administrimi

- 14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Ortakut të Vetëm.

- 14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Ortakut të Vetëm.



- 14.3 Administratori i shoqërisë eshte Z. Marko Taylor, shtetas estonez, lindur më 25.07.1975 ne Estoni, banues ne Villa 326, Mira 1, Dubai, United Arab emirates, mbajtes i Pasaportes me nr. KE0136089.
- 14.4 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
  - Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
  - Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
  - Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;
  - Të zhvillojë veprimitari të tjera të çdo lloj natyre pér të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj;
  - Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri tek palët e treta, insitucionet apo entitetet publike ose private;
  - Të lidhë pér dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;
  - Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm pér mbarëvajtjen e biznesit në Shqipëri;
  - Të vendos pér ndryshimin e selisë së shoqërisë;
  - Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;
  - Të ndërmarrë çdo veprimitari tjetër ose biznes ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm pér biznesin e shoqërisë në Shqipëri.
- 14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm pér 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 15  
Viti finanziar

- 15.1 Viti finanziar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 15.2 Si përashtim, viti i parë finanziar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

**Neni 16**  
Bilanci. Kontabiliteti.


- 16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Ortaku i Vetëm dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve timore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
- 16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.
- 16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekoje pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 17**  
Te Ardhurat. Dividendi

- 17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund t'i kalojne ortakut te vetem.
- 17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe ortaku do të perjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

**Neni 18**  
Likuidimi

- 18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Ortakut të Vetëm.
- 18.2 Me vendimin e Ortakut të Vetëm caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.
- 18.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet përfundimin e tij. Në



përfundim të kësaj proçedure, Ortaku i Vetëm do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e proçedurave të likuidimit.

Neni 19  
Mosmarrëveshjet


- 19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Neni 20  
Klauzolë myllëse

- 20.1 Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje me fuqi të njëjtë ligjore.

Tiranë, datë 09.07.2019

Mercans Albania SHPK  
Ortaku i Vetëm:  
Marko Taylor

  
MARKO TAYLOR